

# KARTA EUROPIANE E AUTONOMISË VENDORE



Kongresi i autoriteteve e lokale dhe rajonale  
të Këshillit të Evropës

The Congress



Le Congrès

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

# **Karta Europiane e Autonomisë Vendore**

English edition:  
*European Charter of Local Self-Government*

Reproduction of the texts in this publication is authorised provided that the full title of the source, namely the Council of Europe, is cited. If they are intended to be used for commercial purposes or translated into one of the non-official languages of the Council of Europe, please contact [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int).

Cover and layout: SPDP, Council of Europe  
Photo: Council of Europe

© Council of Europe, October 2012  
Reprinted September 2018  
Printed at the Council of Europe

## **Tabela e ërmbajtjes**

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.....	5
Karta Evropiane e Autonomisë Vendore .....	9
Protokoll shtesë i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore për të drejtën për pjesëmarrje në punët e një organi vendor .....	23
Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore dhe raporti shpjegues .....	33



# **Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës**

## **Hyrje**

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale është institucion unik në Evropë, përgjegjës për vlerësimin e situatës së demokracisë lokale dhe rajonale në 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Misioni i tij kryesor është forcimi dhe monitorimi i zhvillimeve të demokracisë lokale dhe rajonale.

Në këtë kuadër, Kongresi monitoron zbatimin e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, instrumentin e parë të detyrueshëm ligjor, i miratuar në vitin 1985, nga shtetet anëtare. Karta është bërë traktat reference për sa i përket garantimit të të drejtave të autoriteteve lokale dhe rajonale, të tilla si e drejta për vetëqeverisje, e drejta për zgjedhjen e organeve lokale, e drejta për ushtrimin e kompetencave të tyre, e drejta për struktura administrative dhe burime financiare, dhe e drejta për t'ju drejtuar një gjykatë në rast ndërhyrje nga nivelet e tjera të qeverisjes.

Të gjendur përballë situatave të cilat i konsiderojnë si kërcënim për funksionimin e tyre, autoritetet lokale dhe rajonale gjithmonë e më tepër i drejtohen Kongresit. Këto situata kanë natyrë të ndryshme; ato mund të lidhen me pretendime për shkelje të drejtpërdrejtë të një dispozite të Kartës, të tilla si mungesa e konsultimit të organeve të qeverisjes qendrore me organet e qeverisjes lokale dhe rajonale për një çështje që lidhet drejtpërdrejt me ta (neni 4.6 dhe 9.6), ose për rastet kur burimet

financiare në dispozicion të organeve lokale nuk përkojnë me kompetencat e tyre (neni 9). Këto pretendime mund të lidhen dhe me një cënim të tërthortë të frymës së Kartës. Për shembull, përfaqësuesit e autoriteteve lokale mund t'i kërkojnë Kongresit që, bazuar në Kartë, ai të rishikojë përputhshmërinë e detyrimeve që rrjedhin nga ratifikimi i Kartës nga shteti anëtar. Kongresi mund të analizojë, për shembull, mënyrën se si është ulur numri i bashkive, mund të komentojë një ligj që i ndalon anëtarëve të stafit të një parlamenti të mbajnë një funksion zyrtari lokal, ose të komentojë ndryshimet në një projektligj që mohon këshillat lokale të një qyteti kryeqytet, ose të bëjë konstatime lidhur me ndalimin e përdorimit të një gjuhe pakice në çështjet lokale. Çështjet që i dërgohen Kongresit për opinion lidhur me zbatimin e Kartës mbulojnë një spektër të gjerë.

Nëpërmjet aktiviteteve të tij të monitorimit, Kongresi siguron zbatimin korrekt të Kartës dhe ndihmon për ruajtjen e një vetëqeverisjeje të shëndetshme lokale dhe rajonale në Evropë.

## **Si e monitoron Kongresi demokracinë lokale dhe rajonale?**

### **Kongresi:**

- kryen vizita të rregullta monitorimi në të 47 shtetet anëtare të tij;
- shqyrton aspekte specifike të Kartës
- vëzhgon zgjedhjeve lokale dhe rajonale

Mbi bazën e vizitave të monitorimit, Kongresi përgatit raporte, të cilat miratohen nga Komiteti i Monitorimit. Komiteti miraton

po ashtu dhe rekomandimet, të cilat, pasi miratohen nga Kongresi, i drejtohen shteteve anëtare.

Që prej vitit 1995 janë hartuar thuajse 103 raporte monitorimi nga Kongresi, ndërsa janë ndërmarrë reforma të shumta legjislative nga shtetet anëtare. Po ashtu, është e mundur që shtetet anëtare të Këshillit të Evropës të ratifikojnë dispozitat e papranuara të Kartës në momentin e nënshkrimit të traktatit. Shtetet anëtare mund të marrin dhe hapat e nevojshme për të nënshkruar dhe/ose ratifikuar Protokollin shtesë të Kartës lidhur me të drejtën e pjesëmarrjes në punët e autoritetit vendor.

## **Procedura të zgjeruara për përmirësimin e monitorimit**

Në qershor të vitit 2010, si pjesë e procesit të reformës, Kongresi ka miratuar rregulla për drejtimin e organizimit të procedurave të veta monitoruese (Rezoluta 307 (2010)), e rishikuar në vitin 2013 (Rezoluta 307 (2010) REV2).

Për të përmirësuar cilësinë e monitorimit, Kongresi ka vendosur:

- të realizojë monitorime më të rregullta dhe më sistematike në shtetet që kanë nënshkruar dhe ratifikuar Kartën (mesatarisht një herë në pesë vjet) dhe të prezantojë një metodë më strikte dhe konsistente për caktimin e raportuesve për të garantuar paanshmëri të plotë të delegacionit përgjegjës për monitorimin;
- ta plotësojë këtë proces nëpërmjet përfshirjes së ndihmës pas monitorimit, bazuar në dialogun politik me autoritet kombëtare, në mënyrë që të identifikojë bashkërisht me vendin e përfshirë zgjidhjet më të përshtatshme për problemet e identifikuar nga delegacioni monitorues dhe



të sigurojë zbatimin e shpejtë dhe efektiv të rekomandimeve të bëra nga Kongresi në një "udhërrëfyes" që i dorëzohet qeverisë.

Në këtë mënyrë, Kongresi ndihmon në përmbushjen në nivelin lokal dhe rajonal të objektivave themelore të Këshillit të Evropës, të cilët janë forcimi i demokracisë në kuadër të Kartës së Vetëqeverisjes Vendore dhe Protokollit të saj Shtesë për të drejtën për të marrë pjesë në çështjet e një organi lokal.

# **Karta Europiane e Autonomisë Vendore**



## Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të kësaj Karte,

Duke vlerësuar se qëllimi i Këshillit të Europës është realizimi i një bashkimi me të ngushtë midis anëtarëve të tij për të ruajtur dhe zhvilluar idealet dhe parimet që janë pasuria e tyre e përbashkët;

Duke vlerësuar se një nga mjetet për realizimin e këtij qëllimi është përfundimi i marrëveshjeve në fushën administrative;

Duke vlerësuar se bashkësitë lokale janë një nga themelet kryesore të çdo regjimi demokratik;

Duke vlerësuar se e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në drejtimin e çështjeve publike bën pjesë në parimet demokratike të përbashkëta për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Europës;

Të bindur se në nivelin vendor kjo e drejtë mund të ushtrohet në mënyrë më të drejtpërdrejtë;

Të bindur se ekzistenca e bashkësive vendore të veshura me përgjegjësi efektive mundëson një drejtim njëherazi efikas e nga afër të qytetarit;

Të ndërgjegjshëm se mbrojtja dhe forcimi i autonomisë vendore në vende të ndryshme të Europës përbën një ndihmesë të rëndësishme në ndërtimin e një Europe të bazuar në parimet e demokracisë e të decentralizimit të pushtetit:

Duke pranuar se kjo nënkupton ekzistencën e bashkësive vendore të pajisura me organe vendimore të formuar në mënyrë demokratike dhe që gëzojnë një autonomi të gjerë përsa u përket kompetencave, mënyrave të ushtrimit të këtyre të fundit dhe mjeteve të nevojshme për përmbushjen e misionit të tyre;

Ranë dakord për sa më poshtë:

## **Neni 1**

Palët angazhohen ta konsiderojnë njëra-tjetrën si të lidhura nga nenet që vijojnë, sipas mënyrës dhe në masën e udhëzuar nga neni 12 i kësaj Karte.

## **Pjesa I**

### **Neni 2 – Themeli kushtetues e ligjor i autonomisë vendore**

Parimi i autonomisë vendore duhet të njihet në legjislacionin e brendshëm dhe, po të jetë e mundur, nga Kushtetuta.

### **Neni 3 – Koncepti i autonomisë vendore**

1. Me autonomi vendore kuptohet e drejta dhe aftësia efektive e bashkësive vendore për të rregulluar e për të drejtuar, brenda ligjit, nën përgjegjësinë e tyre dhe në të mirë të popullsisë të tyre, një pjese të mirë të çështjeve publike.
2. Kjo e drejtë ushtrohet nga këshillat apo asamblatë e përbëra nga anëtarë të zgjedhur me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë, të drejtpërdrejtë e universal dhe që mund të

kenë organe ekzekutive përgjegjës para tyre. Kjo dispozitë nuk i pengon qytetarët të mbliidhen në kuvende, referendume apo çdo formë tjetër të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre aty ku lejohet nga ligji.

#### **Neni 4 – Rëndësia e autonomisë vendore**

1. Kompetencat bazë të bashkësisë vendore caktohen nga Kushtetuta ose nga ligji. Megjithatë kjo dispozitë nuk i pengon bashkësitë vendore të marrin kompetenca me qëllime të posaçme, në përputhje me ligjin.

2. Bashkësitë vendore gëzojnë, brenda ligjit, liri të plotë për të ushtruar iniciativën e tyre për çdo çështje që nuk është jashtë kompetencës së tyre apo që mund t'i ketë kaluar një autoriteti tjetër.

3. Ushtrimi i përgjegjësive publike duhet, në mënyrë të përgjithshme, t'i takojë më tepër autoriteteve më të afërta të qytetarëve. Dhënia e një përgjegjësie një autoriteti tjetër duhet të bëhet duke patur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e aftësisë e të ekonomisë.

4. Kompetencat që u besohen bashkësive vendore normalisht duhet të jenë të plota. Ato mund të diskutohen apo të kufizohen nga një autoritet tjetër, qendror apo rajonal vetëm brenda ligjit.

5. Në rast se kompetencat i kalojnë një autoriteti qendror apo rajonal, bashkësitë vendore duhet të gëzojnë, brenda mundësisë, lirinë që ushtrimin e tyre t'ia përshtasin kushteve vendore.

6. Bashkësive vendore duhet t'u kërkohet mendimi brenda mundësisë në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatëshme gjatë proceseve të planifikimit e marrjes së vendimeve për të gjitha çështjet që u përkasin drejtpërsëdrejti.

### **Neni 5 – Mbrojtja e kufijve territorialë të bashkësive vendore**

Për çdo ndryshim të kufijve territorialë vendorë, bashkësive vendore përkatëse duhet t'u merret mendimi paraprakisht, po qe nevoja, me anë referendumi, aty ku e lejon ligji.

### **Neni 6 – Përshtatja e strukturave dhe mjeteve administrative misioneve të bashkësive vendore**

1. Duke ruajtur dispozitat më të përgjithshme, të krijuara nga ligji, bashkësitë vendore mund të përcaktojnë vetë strukturat e brendshme administrative me të cilat duhet të pajisen, me synimin që t'ia përshtasin ato nevojave të tyre specifike dhe të sigurojnë një drejtim efikas.

2. Statuti i personelit të bashkësive vendore duhet të mundësojë një rekrutim cilësor njerëzish, bazuar në parimet e meritës e të aftësisë; për këtë qëllim ai duhet të përmbledhë kushtet e duhura të formimit, të shpërblimit dhe të perspektivave të profesionit.

### **Neni 7 – Kushtet e ushtrimit të përgjegjësive në nivel vendor**

1. Statuti i të zgjedhurve vendorë duhet të sigurojë ushtrimin e lirë të mandatit të tyre.

2. Ai duhet të lejojë kompensimin e duhur financiar të shpenzimeve të bëra gjatë ushtrimit të mandatit, si dhe po të jetë e nevojshme, kompensimin financiar të parave të shpenzuara apo një shpërblim të punës së kryer dhe sigurimin social përkatës.
3. Funkcionet dhe veprimtaritë e papajtueshme me mandatin e të zgjedhurit vendor mund të caktohen vetëm me anë të ligjit ose me parime juridike themelore.

### **Neni 8 – Kontrolli administrativ i veprimeve të bashkësive vendore**

1. Çdo kontroll administrativ mbi bashkësitë vendore mund të ushtrohet vetëm sipas formave dhe në rastet e parashikuara nga Kushtetuta ose nga ligji.
2. Çdo kontroll administrativ i veprimeve të bashkësive vendore normalisht duhet të synojë sigurimin e respektimit të ligjshmërisë dhe të parimeve kushtetuese. Kontrolli administrativ mund, megjithatë të kuptojë një kontroll të ushtruar nga autoritete të nivelit më të lartë lidhur me detyrat, zbatimin e të cilave është kaluar bashkësive vendore.
3. Kontrolli administrativ i kolektiviteteve vendore duhet të ushtrohet duke respektuar përpjestueshmërinë midis rëndësisë së ndërhyrjes së autoritetit kontrollues dhe rëndësisë së interesave që ai kërkon të mbrojë.

### **Neni 9 – Burimet financiare të bashkësive vendore**

1. Bashkësitë vendore kanë të drejtë në kuadrin e politikës ekonomike të vendit, të kenë burimet e tyre të mjaftueshme, të



cilat te mund t'i disponojnë lirisht në ushtrimin e kompetencave të tyre.

2. Burimet financiare të bashkësive vendore duhet të jenë në raport të drejtë me kompetencat e parashikuara nga Kushtetuta ose nga ligji.

3. Të paktën një pjesë e burimeve financiare të bashkësive vendore duhet të sigurohen nga detyrimet dhe taksat vendore, përqindjen e të cilave ato kanë fuqi ta caktojnë në kufijtë që u lejon ligji.

4. Sistemet financiare mbi të cilat mbështeten burimet që disponojnë bashkësitë vendore duhet të jenë të një natyre të sumëllojshme dhe evolutive për t'u dhënë mundësi atyre të ndjekin në praktikë evolucionin real të kostove të ushtrimit të kompetencave të tyre.

5. Mbrojtja e bashkësive vendore më të dobta nga ana financiare kërkon vendosjen e procedurave të rregullimit financiar apo të masave të duhura që synojnë korigjimin e efekteve të ndarjes jo të barabartë të burimeve potenciale të financimit si dhe të përgjegjësive që u takojnë. Të tilla procedura apo masa nuk duhet ta zvogëlojnë lirinë e opsionit të bashkësive vendore në fushën e tyre të përgjegjësisë.

6. Bashkësive vendore duhet t'u kërkohet mendimi në kohën e duhur, mbi mënyrat e përvetësimit të burimeve të rishpërndara.

7. Brenda mundësive, subvencionet e dhëna bashkësive vendore nuk duhet të përdoren për financime projektsh

specifike. Dhënia e subvencioneve nuk duhet të cenojë lirinë themelore të politikës së bashkësive vendore në fushën e tyre të kompetencës.

8. Për të financuar shpenzimet e tyre investuese, bashkësitë vendore duhet sipas ligjit, të hyjnë në tregun kombëtar të kapitaleve.

### **Neni 10 – E drejta për asociacion e bashkësive vendore**

1. Bashkësitë vendore kanë të drejtë gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre të bashkëpunojnë dhe, brenda ligjit, të bashkohen me bashkësi të tjera vendore për të realizuar detyrat me interes të përbashkët.

2. E drejta e bashkësive vendore për të aderuar në një shoqatë për mbrojtjen dhe nxitjen e interesave të tyre të përbashkëta, si dhe e drejta për të aderuar në një shoqatë ndërkombëtare të bashkësive vendore duhet të njihen në çdo shtet.

3. Në rast nevoje bashkësitë vendore mund, në kushtet e parashikuara nga ligji, të bashkëpunojnë me bashkësi të shteteve të tjera.

### **Neni 11 – Mbrojtja ligjore e autonomisë vendore**

Bashkësitë vendore duhet të gëzojnë të drejtën e kërkesës juridikionale me qëllim që të sigurojnë ushtrimin e lirë të kompetencave të tyre dhe respektimin e parimeve të autonomisë vendore të njohura nga Kushtetuta apo legjislacioni i brendshëm.

## **Pjesa II – Dispozita të ndryshme**

### **Neni 12 – Angazhime**

1. Çdo palë angazhohet ta konsiderojë veten si të lidhur nga njëzet të paktën prej paragrafëve të pjesës I të Kartës, dhjetë të paktën prej të cilave janë zgjedhur midis paragrafeve që vijojnë:

- neni 2,
- neni 3, paragrafet 1 dhe 2,
- neni 4, paragrafet 1, 2 dhe 4,
- neni 5,
- neni 7, paragrafi 1,
- neni 8, paragrafi 2,
- neni 9, paragrafet 1,2 dhe 3,
- neni 10, paragrafi 1,
- neni 11.

2. Çdo shtet kontraktues, në çastin e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit ose të aprovimit, i bën të ditur Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës paragrafet e zgjedhur në përputhje me dispozitën e paragrafit 1 të këtij neni.

3. Çdo Palë mund, në çdo moment të mëvonshëm, të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm se e konsideron veten si të lidhur nga çdo paragraf tjetër i kësaj Karte, të cilin ajo ende nuk e kishte pranuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni. Këtë angazhime të mëvonshme do të quhen pjesë përbërëse të ratifikimit, të pranimit apo të aprovimit të Palës që bën njoftimin dhe do të sjellin të njëjtat efekte që nga dita e parë e muajit që vijon mbas skadimit të një periudhe

tremujore mbas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

### **Neni 13 – Bashkësitë për të cilat zbatohet Karta**

Parimet e autonomisë vendore që përmban kjo Kartë zbatohen për të gjitha kategoritë e bashkësive vendore që ekzistojnë në territorin e Palës. Megjithatë, çdo Palë mund në çastin e depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit të pranimit apo të miratimit, të caktojë kategoritë e bashkësive vendore apo krahinore në të cilat ajo mendon ta kufizojë fushën e zbatimit apo që ajo mendon ta kufizojë fushën e zbatimit apo që ajo mendon të përjashtojë nga fusha e zbatimit të kësaj Karte. Ajo mund të përfshijë, gjithashtu, edhe kategori të tjera bashkësisht vendore ose krahinore në fushën e zbatimit të Kartës me anë të një njoftimi të mëvonshëm Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

### **Neni 14 – Komunikimi i informacioneve**

Çdo Palë i transmeton Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës çdo informacion të nevojshëm lidhur me dispozitat legjislative e masa të tjera që ajo ka marrë me qëllim që t'i përshtatet klauzolave të kësaj Karte.

## **Pjesa III**

### **Neni 15 – Nënshkrimi, ratifikimi, hyrja në fuqi**

1. Kjo Kartë është e hapur për nënshkrim për shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Ajo do të ratifikohet, të pranohet apo të miratohet. Instrumentet e ratifikimit, të pranimit apo të

miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Kjo Kartë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vijon mbas skadimit të një periudhe tremujore mbas datës kur katër shtete anëtare të Këshillit të Europës do të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur prej Kartës, në përputhje me dispozitat e paragrafit të mëparshëm.

3. Për çdo shtet tjetër anëtar që do të shprehë më vonë pëlqimin të lidhet me anë të Kartës, kjo do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit që vijon mbas skadimit të një periudhe tremujore mbas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, të pranimit apo të miratimit.

## **Neni 16 – Klauzola territoriale**

1. Çdo shtet mund, në çastin e nënshkrimit apo depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, të pranimit, të miratimit apo të aderimit, të caktojë territorin apo territoret për të cilët do të zbatohet kjo Kartë.

2. Çdo shtet mund në çdo çast tjetër të mëvonshëm, me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, ta shtrijë zbatimin e kësaj Karte në çdo territor tjetër të caktuar në deklaratë. Karta do të hyjë në fuqi përkundrejt këtij territori, ditën e parë të muajit që vijon mbas skadimit të një periudhe tremujore mbas datës së pranimit të deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafeve të mëparshëm që ka të bëjë me çdo territor të caktuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në veprim ditën e parë

të muajit që vijon mbas skadimit të një periudhe gjashtëmujore mbas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

### **Neni 17 – Denoncimi**

1. Asnjë Palë nuk mund ta denoncojë këtë Karte para skadimit të një periudhe pesëvjeçare mbas datës kur Karta ka hyrë në fuqi për sa i përket këtij Pale. Një noftim gjashtë muaj më parë do të bëhet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Ky denoncim nuk prek vlefshmërinë e Kartës kundrejt Palëve të tjera, me kusht që numri i tyre të mos jetë asnjëherë më pak se katër.

2. Çdo Palë mund, në përputhje me dispozitat e dhëna në paragrafin e mëparshëm, të denoncojë çdo paragraf të pjesës I të Kartës që ajo ka pranuar, me kusht që numri dhe kategoria e paragrafeve të cilëve u përmbahet kjo Kartë të mbeten në përputhje me dispozitat e nenit 12, paragrafi 1. Çdo Palë që mbas denoncimit të një paragrafi nuk përputhet më me dispozitat e nenit 12, paragrafi 1, do të konsiderohet sikur ka denoncuar vetë Kartën.

### **Neni 18 – Njoftime**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës u bën të ditur shteteve anëtare të Këshillit:

- a. çdo nënshkrim;
- b. depozitimim e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi apo miratimi;
- c. çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Karte në përputhje me nenin 15 të saj;

- d. çdo njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 12, paragrafet 2 dhe 3;
- e. çdo njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 13;
- f. çdo akt tjetër, njoftim apo komunikim që ka të bëjë me këtë Kartë.

**Protokoll shtesë i Kartës Evropiane  
të Vetëqeverisjes Vendore  
për të drejtën për pjesëmarrje  
në punët e një organi vendor**

**Utreht, 16. XI. 2009**





## **Preambula**

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të këtij Protokolli Shtesë të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore (më poshtë "Karta", ETS nr. 122),

Duke ditur që qëllimi i Këshillit të Evropës është të arrijë më shumë unitet ndërmjet anëtarëve të saj me qëllimin e garantimit dhe realizimit të ideve dhe të parimeve që janë trashëgimia jonë e përbashkët;

Duke ditur që e drejta për pjesëmarrje në kryerjen e punëve publike është një ndër parimet demokratike të përbashkëta për të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës;

Duke ditur që zhvillimi në shtetet anëtare ka dëshmuar rëndësinë e jashtëzakonshme të këtij parimi për qeverisjen vendore;

Duke qenë të mendimit se është me vend që Karta të shtohet me dispozita të cilat garantojnë të drejtën për pjesëmarrje në punët e një organi vendor;

Duke pasur parasysh Konventën e Këshillit të Evropës për Akses në Dokumentet Zyrtare, miratuar nga Komiteti i Ministrave më 27 nëntor 2008;

Duke pasur po ashtu parasysh Deklaratën dhe Planin e Veprimit të miratuar në Samitin e 3-të të Krerëve të Shteteve të Këshillit të Evropës (Varshavë, 16 deri më 17 maj 2005),

Bien dakord si më poshtë:

## **Neni 1 – E drejta për pjesëmarrje në punët e një organi vendor**

1. Shtetet palë sigurohen se gjithkush brenda juridiksionit të tyre gëzon të drejtën e pjesëmarrjes në punët e një organi vendor.

2. E drejta e pjesëmarrjes në punët e një organi vendor nënkupton të drejtën për të kërkuar të përcaktosh ose të kesh ndikim mbi ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të një organi vendor.

3. Ligji parashikon mjetet e lehtësimit të ushtrimit të kësaj të drejte. Pa diskriminuar padrejtësisht asnjë person ose grup, ligji mund të parashikojë masa të posaçme për rrethana ose kategori të ndryshme personash. Në përputhje me detyrimet kushtetuese dhe/ose ndërkombëtare të shtetit palë, ligji mund të parashikojë në veçanti masa të cilat kufizohen posaçërisht për votuesit.

4.1. Çdo palë njihet, me anë të ligjit, të drejtat e nënshtetasve të saj për pjesëmarrje qoftë si votues ose si kandidatë në zgjedhjet për anëtarët e këshillit, ose të asamblesë së organit vendor ku ata jetojnë.

4.2. Ligji njihet po ashtu të drejtën e personave të tjerë për pjesëmarrje atëherë kur pala vendos për të në përputhje me rendin e saj kushtetues, ose kur kjo e drejtë për pjesëmarrje përkon me detyrimet ligjore ndërkombëtare të saj.

5.1. Të gjitha formalitetet, kushtet ose kufizimet në të drejtën për pjesëmarrje në punët e një organi vendos parashikohen në

ligj dhe janë në përputhje me detyrimet ligjore ndërkombëtare të palës.

5.2. Ligji i parashikon këto formalitete, kushte ose kufizime sipas nevojës, për të siguruar moscenimin e integritetit etik dhe transparencën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive të organeve vendore nga ushtrimi i së drejtës për pjesëmarrje.

5.3. Çdo formalitet, kusht ose kufizim tjetër duhet të jetë i nevojshëm për funksionimin e një demokracie efektive politike, për ruajtjen e sigurisë publike në një shtet demokratik, ose për plotësimin e kërkesave që rrjedhin për përmbushjen e detyrimeve ligjore ndërkombëtare për shtetin palë.

## **Neni 2 – Zbatimi i masave për të drejtën për pjesëmarrje**

1. Palët marrin të gjitha masat e nevojshme për të vënë në jetë të drejtën e pjesëmarrjes në punët e organit vendor.

2. Këto masa për ushtrimin e së drejtës për pjesëmarrje përfshijnë:

i. fuqizimin e organeve vendore për të bërë të mundur, nxitur dhe lehtësuar ushtrimin e së drejtës për pjesëmarrje, siç parashikohet në këtë Protokoll;

ii. sigurimin e përcaktimit të:

a. procedurave për përfshirjen e njerëzve, të cilat mund të përfshijnë proceset konsultative, referendumet dhe petitionet vendore dhe masa për përfshirjen e njerëzve në një nivel që është

më pranë tyre në rast se organi lokal ka shumë banorë dhe/ose mbulon një zonë të madhe gjeografike;

- b. procedurave për akses në dokumentet zyrtare të mbajtura nga organet lokale, në përputhje me rendin kushtetues të palës dhe me detyrimet ligjore ndërkombëtare të saj;
  - c. masave për plotësimin e nevojave të kategorive të personave të cilët hasen me vështirësi specifike lidhur me pjesëmarrjen; dhe
  - d. mekanizmave dhe procedurave për të trajtuar dhe për t'ju përgjigjur ankesave dhe sugjerimeve lidhur me funksionimin e organeve vendore dhe shërbimet publike vendore;
- iii. inkurajimin e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit për nxitjen dhe ushtrimin e të drejtës për pjesëmarrje, të parashikuar në këtë Protokoll.

3. Procedurat, masat dhe mekanizmat mund të jenë të ndryshme për kategori të ndryshme të organeve vendore, duke pasur parasysh madhësinë dhe kompetencat e tyre.

4. Gjatë proceseve të planifikimit dhe të vendimmarrjes lidhur me masat që duhet ndërmarrë për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës për pjesëmarrje në punët e një organi vendor, organet vendore konsultohen sa më shumë të jetë e mundur në kohën e duhur dhe në mënyrën e përshtatshme.

### **Neni 3 – Organet mbi të cilat zbatohet Protokoll**

Ky Protokoll zbatohet për të gjitha kategoritë e organeve vendore që ekzistojnë brenda territorit të shteteve palë. Pavarësisht nga kjo, gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, çdo shtet mund të specifikojë kategoritë e organeve lokale dhe rajonale të cilat ai synon të përjashtojë nga zbatimi i këtij Protokoll. Po ashtu, çdo shtet mund të përfshijë kategori të tjera të organeve lokale ose rajonale brenda objektit të zbatimit të Protokollit, pas njoftimit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

### **Neni 4 – Zbatimi territorial**

1. Në kohën e nënshkrimit, ose gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit, çdo shtet specifikon territorin ose territoret mbi të cilat zbatohet ky Protokoll.
2. Çdo palë mund të shtrijë zbatimin e këtij Protokoll, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, në çdo territor tjetër të përmendur në këtë deklaratë në çdo kohë tjetër të mëvonshme. Për këta territore, Protokollin hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës prej tre muajsh nga data e marrjes së kësaj deklarate nga Sekretari i Përgjithshëm.
3. Çdo deklaratë e bërë në përputhje me dispozitat e dy paragrafëve më lart mund të tërhiqet me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës në lidhje me territorin e specifikuar në këtë deklaratë. Tërheqja

hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës gjashtëmujore nga data e marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

## **Neni 5 – Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës nënshkruese të Kartës. Ai është objekt ratifikimi, pranimit ose miratimit. Një shtet anëtar i Këshillit të Evropës mund të ratifikojë, pranojë ose miratojë këtë Protokoll vetëm nëse ai e ka ratifikuar, pranuar ose miratuar Kartën ose në të njëjtën kohë, ose më parë. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen tek Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës.
2. Ky Protokoll hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas përfundimit të afatit tremujor nga data në të cilën tetë shtete anëtare të Këshillit të Evropës kanë shprehur pëlqimin e tyre për të zbatuar Protokollin në përputhje me dispozitat e paragrafit 1.
3. Në lidhje me shtetet anëtarë të cilat shprehin pëlqimin për të zbatuar Protokollin më pas, Protokollin hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të periudhës tremujore nga data e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

## **Neni 6 – Denoncimi**

1. Çdo palë mund ta denoncojë këtë Protokoll në çdo kohë me anë të një njoftimi që i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

2. Ky denoncim hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas përfundimit të afatit prej gjashtë muajsh nga data e marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

## **Neni 7 – Njoftimet**

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës njofton çdo shtet anëtar të Këshillit të Evropës për:

- a. çdo nënshkrim;
- b. depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose miratimi;
- c. datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokoll, në përputhje me dispozitën e Nenit 5;
- d. çdo njoftim të marrë në zbatim të dispozitave të Nenit 3;
- e. çdo akt, njoftim ose komunikim tjetër të lidhur me këtë Protokoll.

Protokollin nënshkruhet në prani të nënshkruesve, të autorizuar zyrtarisht për nënshkrimin e këtij dokumenti.

Nënshkruar në Utreht, më 16 nëntor 2009, në versionin në anglisht dhe në frëngjisht, ku tekstet në të dyja gjuhët janë të barazvlefshme, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës i jep një kopje të noterizuar secilit nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.





# **Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore dhe raporti shpjegues**

**Traktate dhe raporte**



I. Karta Evropiane për Vetëqeverisjes Lokale është hartuar brenda Këshillit të Evropës nga një komitet ekspertësh qeveritarë, nën drejtimin e Komitetit Drejtues për Çështje Rajonale dhe Bashkiake, bazuar mbi një projekt të propozuar nga Konferenca e Përhershme e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës. Ajo u hap për nënshkrim si konventë për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës më 15 tetor 1985.

II. Ky botim përmban tekstin e raportit shpjegues, përgatitur mbi bazën e diskutimeve të komisionit, i cili i është dërguar dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Ky raport nuk përbën një instrument me interpretim autoritar të tekstit të Kartës, megjithëse mund të lehtësojë të kuptuarin e dispozitave të saj.

III. Teksti i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore është riprodhuar në këtë botim.

# Raport shpjegues

## A. Origjina e Kartës

Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore është akumulim i shumë iniciativave dhe i shumë vitesh punë brenda Këshillit të Evropës.

Mbrojtja dhe forcimi i autonomisë vendore në Evropë me anë të një dokumenti që përfshin parimet e përqafuara nga të gjitha shtetet demokratike të Evropës është një ambicie e vjetër e qarqeve të qeverive vendore. Për më tepër, është pranuar që në një fazë të hershme që ky tekst duhet të synojë aderimin e atyre organeve, veprimet e të cilëve janë shumë të rëndësishme në çdo mbrojtje të autonomisë vendore –pra, aderimin e qeverive.

Këshilli i Evropës si rojtari i të drejtave të njeriut dhe si mbajtësi i parimeve të qeverisjes demokratike, është kuadri i duhur brenda të cilit mund të hartohet dhe të miratohet një instrument i tillë. Kjo bëhet akoma më e vërtetë për shkak se që prej vitit 1957, Këshilli i Evropës ka shprehur vlerësimin që i jep rëndësisë së organeve vendore, duke krijuar për ta një organ përfaqësues në nivelin evropian, i cili që prej asaj kohe është transformuar në Konferencën e Përhershme të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës (CLRAE).<sup>1</sup>

Ishte pikërisht kjo Konferencë e cila, në Rezolutën e saj 64 (1968), propozoi një Deklaratë Parimesh për Autonominë

---

1. Që prej 14 janarit 1994, Konferenca e Përhershme u transformua në një Kongres Autoritetesh Rajonale të Evropës (CLRAE), në shenjë njohjeje të domethënies së saj politike.

Vendore dhe i bëri thirrje Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës ta miratonte këtë Deklaratë. Kjo iniciativë u mbështet nga Asambleja Konsultative, e cila në Rekomandimin 615 (1970) i paraqiti Komitetit të Ministrave një tekst të bazuar fort në tekstin e Konferencës së Përhershme të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës dhe të hartuar bashkërisht të dy organet. Deklarata e propozuar kishte karakter shumë të përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës për të lejuar marrjen e ndonjë veprimi të qenësishëm.

Iniciativa e re e CLRAE-it në vitin 1981 u bazua në një qasje më dinamike, por u mor parasysh dhe pikëpamja se një deklaratë e thjeshtë jo detyruese e parimeve nuk mund të justifikonte rëndësinë e autonomisë vendore, ose natyrën e kërcënimeve ndaj të cilave ishte e ekspozuar ajo. Në të kundërtën, u tha se qeverive duhet t'u kërkohet të hyjnë në angazhime detyruese. Fleksibiliteti i nevojshëm për të marrë parasysh dallimet ndërmjet organizimeve kushtetuese kombëtare dhe traditave administrative duhej të ndërtohej jo duke reduktuar shprehimisht kërkesat e instrumentit të ri, por duke u lejuar qeverive një nivel përzgjedhjeje në lidhje me dispozitat që do të ishin detyruese për ta.

Rezultati logjik i kësaj qasjeje ishte paraqitja për Komitetin e Ministrave, në Rezolutën 126 (1981), nga CLRAE i një projekt karte evropiane të vetëqeverisjes vendore, me kërkesën që ajo të miratohej me statusin e një konvente evropiane.

Komiteti i Ministrave vendosi t'ia transmetonte propozimet e CLRAE-s Komitetit Drejtues për Çështje Rajonale dhe Bashkiake (CDRM) me synimin e diskutimit të tyre në Konferencën e 5-të të ministrave evropianë përgjegjës për qeveritë vendore

(Lugano, 5-7 tetor 1982). Në përfundimet e tyre, ministrat e pranishëm në Lugano u shprehën se

“...mendojnë se kjo draft kartë përbën një hap të rëndësishëm drejt përcaktimit të parimeve të autonomisë vendore, ndërsa vëren rezervat e disa ministrave rreth nevojës për një kartë në formën e një konvente të detyrueshme dhe rreth disa aspekteve të përmbajtjes së saj;

I kërkuan Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës ta udhëzonte Komitetin Drejtues për Çështjet Rajonale dhe Bashkiake (CDRM) që, në bashkëpunim me Konferencën e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës, të bënin ndryshimet e nevojshme në projekt kartën evropiane të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me komentet e lidhura me formën dhe përmbajtjen, të bëra gjatë konferencës, në mënyrë që ky tekst t’u dërgohej ministrave për miratim në konferencën e tyre pasardhëse ...”

Komiteti i Ministrave, siç u udhëzua nga CDRM-ja, bëri një rishikim të plotë të projekt kartës. Gjatë diskutimeve për zbatimin e përfundimeve të Konferencës së Luganos morën pjesë dhe përfaqësues nga CLRAE.

Teksti i projekt kartës u rishikua nga CDRM-ja dhe iu dërgua Konferencës së 6 të ministrave evropiane përgjegjës për qeverisjet vendore, të cilët u mbledhën në Romë nga data 6 deri më 8 nëntor 1984. Pas shqyrtimit të këtij teksti, ministrat shprehën miratimin e tyre unanim për parimet e përfshira në të. Në lidhje me formën ligjore që duhej të merrte karta, pjesa më e madhe e ministrave u shprehën pro një konvente.

Në kuadrin e opinioneve të Asamblesë Konsultative dhe konferencës së ministrave në Romës, Komiteti i Ministrave miratoi Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore në formën e një konvente në qershor të vitit 1985. Në njohje të

faktit që iniciativa për kartën kishte ardhur nga Konferenca e Përhershme e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës, u vendos që konventa të haqej për nënshkrim më 15 tetor 1985, me rastin e sesionit të 20-të plenar të CLRAE-s.

## **B. Komente të përgjithshme**

Qëllimi i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore është të plotësojë mungesën e standardeve të përbashkëta evropiane për matjen dhe garantimin e të drejtave të organeve vendore, të cilat janë më pranë qytetarëve, dhe t'i japë qytetarëve mundësinë e pjesëmarrjes efektive në marrjen e vendimeve që kanë ndikim mbi mjedisin e përditshëm të tyre.

Karta i angazhon palët të zbatojnë rregullat bazë që garantojnë pavarësinë politike, administrative dhe financiare të organeve vendore. Pra, ajo demonstroi në nivelin evropian vullnetin politik për t'i dhënë jetë në të gjitha nivelet e administrimit territorial parimeve të mbrojtura që prej themelimit të saj nga Këshilli i Evropës, i cili e konsideron si funksionin e tij ruajtjen e ndërgjegjes demokratike të Evropës dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kuptimin më të gjerë të mundshëm. Në të vërtetë, Këshilli është i bindur se niveli i vetëqeverisjes që gëzohet nga të gjitha organet vendore mund të konsiderohet si gur prove i demokracisë së vërtetë.

Karta përmban tri pjesë. Pjesa e parë përmban dispozitat kryesore të parashikojnë parimet e vetëqeverisjes vendore. Ajo specifikon nevojën e themelit kushtetues dhe ligjor për vetëqeverisjen vendore, përkufizon konceptin dhe jep parimet që udhëheqin natyrën dhe objektin e kompetencave të organeve vendore. Më tej, nenet lidhen me mbrojtjen e kufijve të organeve lokale, duke pasur parasysh se ata kanë autonomi



për strukturën administrative dhe marrjen në punë e personelit të aftë dhe duke përcaktuar kushtet për mbajtjen e një posti të zgjedhur vendor. Dy nenet kryesore lidhen me kufizimin e mbikëqyrjes administrative të aktiviteteve të organeve vendore dhe me të siguruarin që ata kanë burime të mjaftueshme financiare në dispozicion, aq sa nuk cenohet autonomia bazë. Pjesa tjetër e mbetur e dispozitave në këtë pjesë mbulon të drejtën e organeve vendore për të bashkëpunuar dhe për të formuar shoqata, si dhe mbrojtjen e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet të drejtës së rekursit për zgjidhje ligjore.

Pjesa II përmban dispozita të ndryshme lidhur me objektin e angazhimeve të ndërmarra nga palët. Në përputhje me synimin e të siguruarit të një ekuilibri real ndërmjet garantimit të parimeve themelore dhe fleksibilitetit të nevojshëm për të marrë parasysh veçantitë ligjore dhe institucionale të shteteve të ndryshme anëtare, Karta i lejon palët të përjashtojnë dispozita specifike të Kartës nga ato dispozita të cilat ata i konsiderojnë të detyrueshme. Në këtë mënyrë, karta përfaqon një kompromis ndërmjet të pranuarit të faktit që vetëqeverisja vendore prek strukturën dhe organizimin e vetë shtetit, gjë që është shqetësim bazë për qeverinë, nga njëra anë, dhe objektivin e mbrojtjes së parimeve bazë që duhet të respektohet nga çdo sistem demokratik i qeverisjes vendore, nga ana tjetër. Për më tepër, parashikohet që angazhimet e palëve mund të shtohen pasi të jenë hequr pengesat përkatëse.

Mundësisht, parimet e vetëqeverisjes vendore të parashikuara në kartë zbatohen në të gjitha nivelet ose kategoritë e organeve vendore të të gjitha shtetet anëtare, dhe po ashtu, *mutatis mutandis*, dhe në organet territoriale në nivelin rajonal. Gjithsesi, për të lejuar raste specifike, palëve u lejohej të

përfashtojnë kategori të caktuara organesh nga objekti i kësaj karte.

Karta nuk parashikon një sistem të institucionalizuar kontrolli për zbatimin e saj përtej kërkesës për palët për të dhënë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me masat legjislative ose masat e tjera të marra me qëllimin e realizimit të përputhshmërisë me Kartën. Në fakt u mendua dhe për mundësinë e krijimit të një sistemi ndërkombëtar mbikëqyrjeje të ngjashëm me atë të Kartës Sociale Evropiane. Gjithsesi, u pa e udhës të mos krijohet një makineri komplekse mbikëqyrëse, pasi prania e CLRAE brenda Këshillit të Evropës, duke pasur akses të drejtpërdrejtë tek Komiteti i Ministrave, siguron kontrollin e nevojshëm politik të përputhshmërisë së kërkesave të kartës nga palët.

Pjesa e fundit e tekstit përmban dispozita përfundimtare, të cilat janë në përputhje me dispozitat e zakonshme të përdorura në konventat e hartuara nën mbikëqyrjen e Këshillit të Evropës.

Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore është instrumenti i parë ligjor shumëpalësh që përcakton dhe garanton parimet e autonomisë vendore, një ndër shtyllat e demokracisë, mbrojtja dhe zhvillimi i së cilës është detyrë e Këshillit të Evropës. Mund të shpresohet që në këtë mënyrë, ajo do të japë një kontribut thelbësor për mbrojtjen dhe zgjerimin e vlerave të përbashkëta të Evropës.

## **C. Komentar mbi dispozitat e Kartës**

### **Preambula**

Preambula parashikon mundësinë e deklarimit të elementëve bazë të kartës. Ato janë, kryesisht:

- kontributi jetik i vetëqeverisjes lokale për demokracinë, administrimin efektiv dhe decentralizimin e kompetencave;
- roli i rëndësishëm i organeve vendore në ndërtimin e Evropës;
- nevoja e organeve lokale që të zgjidhen në mënyrë demokratike dhe të gëzojnë autonomi të gjerë.

### *Neni 1*

Neni 1 shpreh angazhimin e përgjithshëm të palëve për të respektuar parimet e vetëqeverisjes vendore, të parashikuara në pjesën e parë të Kartës (nenet 2-11) deri në masën e parashikuar në nenin 12.

### *Neni 2*

Ky nen parashikon që parimi i vetëqeverisjes vendore duhet të jetë i mishëruar në ligjin e shkruar.

Duke pasur parasysh rëndësinë e parimit, është e dëshirueshme që kjo të arrihet duke e përfshirë parimin e vetëqeverisjes vendore në tekstin bazë që parashikon organizimin e shtetit, pra në kushtetutë. Gjithsesi, u pranua që në ato vende në të cilat procedura për ndryshimin e kushtetutës kërkon pëlqimin e një shumice të cilësuar të ligjbërësve, ose pëlqimin e të gjithë popullsisë së shprehur në një referendum, mund të mos jetë e mundur që këto shtete të angazhohen për mishërimin e parimit të vetëqeverisjes vendore në kushtetutë. Po ashtu, u pranua që shtetet që nuk kanë kushtetutë të shkruar, por një kushtetutë që mund të gjendet në dokumente dhe në burime të ndryshme mund të hasen me vështirësi specifike ose

mund të mos jenë në gjendje të angazhohen për pasqyrimin e vetëqeverisjes vendore në kushtetutë.

Po ashtu, duhet të merret parasysh dhe fakti që në shtetet federale, qeverisja vendore mund të jetë rregulluar nga shtetet federale, dhe jo nga qeverisja qendrore federale. Për shtetet federale kjo kartë nuk cenon në asnjë mënyrë ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësive ndërmjet shtetit federal dhe shteteve të federuara.

### *Neni 3*

Ky nen parashikon karakteristikat bazë të vetëqeverisjes lokale, pasi ato duhet të kuptohen për qëllimet e Kartës.

#### *Paragrafi 1*

Nocioni i “aftësisë” shpreh idenë që e drejta ligjore për të rregulluar dhe menaxhuar çështje të caktuara publike duhet të shoqërohet me mjetet që e bëjnë të mundur realizimin efektiv të të tyre. Përfshirja e shprehjes “brenda kufijve ligjorë” njeh faktin se kjo e drejtë dhe aftësi mund të përcaktohen më nga afër nga legjislacioni.

“Nën përgjegjësinë e tyre” thekson që organet vendore nuk duhet të jenë të kufizuara vetëm në të vepruarin si agjentë të organeve më të larta.

Është e pamundur të përcaktohen ekzaktësisht se çfarë çështjesh organet vendore kanë të drejtë të trajtojnë dhe të menaxhojnë. Shprehje të tilla si “çështjet vendore” ose “çështjet e veta” janë kundërshtuar si shumë të përgjithshme dhe shumë të vështira për t’u interpretuar. Traditat e shteteve anëtare në lidhje me çështjet që konsiderohen se u përkasin organeve vendore janë shumë të ndryshme. Në fakt, pjesa

më e madhe e çështjeve kanë implikime edhe vendore edhe kombëtare, dhe përgjegjësia rreth tyre mund të ndryshojë nga njëri vend në tjetrin, dhe njëra kohë në tjetrën, dhe madje kjo përgjegjësi edhe mund të ndahet ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Të kufizuarit e organeve vendore tek çështje të cilat nuk kanë ndikime më të gjera, do të rrezikonte uljen e statusit të tyre, duke i lidhur organet vendore me një rol skajor. Nga ana tjetër, është pranuar që shtetet dëshirojnë të mbajnë funksione të caktuara për vete, si për shembull sigurinë kombëtare. Synimi i kartës është që organet vendore të kenë një gamë të gjerë përgjegjësish, të cilat mund të realizohen në nivelin vendor. Përcaktimi i këtyre përgjegjësive është objekti i nenit 4.

### *Paragrafi 2*

E drejta e vetëqeverisjes duhet të ushtrohet nga organe të krijuara në mënyrë demokratike. Ky parim është në përputhje me rëndësinë që Këshilli i Evropës i jep formave demokratike të qeverisjes.

Kjo e drejtë përfshin normalisht një asamble përfaqësuese me ose pa organe ekzekutive në varësi të saj, por lejohet gjithashtu dhe mundësia e demokracisë së drejtpërdrejtë, në rastet kur kjo parashikohet në statut.

### *Neni 4*

Siç u shpjegua në komentet e nenit 3, nuk është e mundur, dhe as nuk do të ishte e përshtatshme të përpiqeshim të numëronim në një listë shteruese kompetencash dhe përgjegjësish që lidhen me qeverisjen vendore në të gjithë Evropën. Gjithsesi, ky nen parashikon parimet e përgjithshme mbi të cilat duhet

të bazohen përgjegjësitë e qeverive vendore dhe natyrën e kompetencave të tyre.

### *Paragrafi 1*

Përderisa natyra e përgjegjësiave të organeve vendore është thelbësore për realitetin e vetëqeverisjes vendore, është në interesin e qartësisë dhe sigurisë juridike që të përcaktohen përgjegjësitë bazë të qeverive vendore mbi bazë *ad hoc*, të cilat duhet të jenë mjaftueshmërisht të reflektuara në legjislacion. Në realitet përgjegjësitë duhet të parashikohen nga kushtetuta ose nga një akt parlamenti (ligj). Por, pavarësisht nga përdorimi i fjalës “statut” në këtë paragraf, pranohet që në disa shtete mund të jetë e dëshirueshme që për hir të efikasitetit parlamenti të delegojë kompetenca për caktimin e përgjegjësiave specifike, në veçanti në lidhje me detajet ose me çështjet që kërkojnë zbatim për shkak të direktivave të Komunitetit Evropian, me kusht që parlamenti të mbajë kompetencat e nevojshme të mbikëqyrjes mbi përdorimin e kompetencave të deleguara. Po ashtu, parashikohet një përjashtim në rastin e shteteve anëtare të Komunitetit Evropian, për aq kohë sa rregulloret e komunitetit (sipas të cilave neni 189 i Traktatit të Romës është drejtpërsëdrejti i zbatueshëm) parashikojnë zbatimin e një mase specifike në një nivel të caktuar administrimi.

### *Paragrafi 2*

Përveç përgjegjësiave që i caktohen nga legjislacioni niveleve të ndryshme të qeverisjes, mund të shfaqen nevoja ose mundësi të tjera për veprim nga organet publike. Në rastet ku këto fusha veprimi kanë ndikime vendore dhe kur organet vendore nuk përjashtohen nga marrja e kompetencave të përgjithshme në pjesën më të madhe të shteteve, është e rëndësime për

konceptimin e organeve vendore si subjekte politike që të veprojnë sipas legjislacionit së tyre për të ushtruar iniciativën e tyre në këto çështje. Rregullat e përgjithshme sipas të cilave organet vendore mund të veprojnë në raste të tilla mund të jenë të parashikuara në ligj. Gjithsesi, në shtete të caktuara anëtare, organet vendore duhet të jenë në gjendje të kenë të drejta ligjore (statutore) për të bazuar veprimet e tyre. Sipas këtij sistemi, ekzistenca e të cilit mbulohet nga neni 4, paragrafi 2, organeve vendore mund t'u jepet diskrecion i gjerë që shkon përtej përgjegjësive specifike.

### *Paragrafi 3*

Ky paragraf artikulon parimin e përgjithshëm që ushtrimi i përgjegjësive publike duhet të decentralizohet. Ky parim është përmendur në disa raste brenda kuadrit të Këshillit të Evropës, dhe në veçanti në përfundimet e Konferencës së Lisbonës për ministrat evropianë përgjegjës për qeveritë vendore në vitin 1977. Ai nënkupton që, në përjashtim të rasteve kur përmasa ose natyra e një detyre është e tillë sa që kërkon trajtim brenda një zone më të madhe territoriale, ose kur ka çështje epërsie efikasiteti ose ekonomie, përgjegjësitet publike duhet t'i besohet përgjithësisht nivelit të qeverisjes që është më pranë qytetarëve.

Gjithsesi, kjo klauzolë nuk nënkupton një kërkesë sistematike për decentralizim funksionesh tek organe të tilla vendore të cilat, për shkak të natyrës dhe madhësisë së tyre, mund të realizojnë vetëm detyra të kufizuara.

### *Paragrafi 4*

Ky paragraf trajton çështjen e përgjegjësive të mbivendosura. Për të qenë të qartë dhe për qëllimin e shmangies së çdo

tendence për pakësim të vazhdueshëm të përgjegjësive, kompetencat normalisht duhet të jenë të plota dhe ekskluzive. Por, pavarësisht nga kjo, në fusha të caktuara kërkohen veprime plotësuese nga nivelet e ndryshme të qeverisjes dhe në këto raste është e rëndësishme që ndërhyrja nga organet qendrore dhe rajonale të kryhet në përputhje me dispozita të qarta legjislative.

### *Paragrafi 5*

Strukturat administrative të organeve vendore dhe njohja e tyre nga afër me kushtet vendore, mund t'i bëjnë ata organet e përshtatshme për realizimin e funksioneve të caktuara, përgjegjësia përfundimtare për të cilat u takon organeve supra-vendore. Gjithsesi, është e rëndësishme që organi i qeverisjes vendore, kur është e mundur, të lejohet të marrë parasysh rrethanat lokale gjatë ushtrimit të kompetencave të deleguara, në mënyrë që kthimi tek ky delegim të mos cenohet me tepri sferën e autoritetit të pavarësisë së organit vendor. Nga ana tjetër, pranohet që në respektim të disa funksioneve, të tilla si lëshimi i dokumenteve të identifikimit, nevoja për rregullore të unifikuara mund të mos lërë vend për diskrecion vendor.

### *Paragrafi 6*

Ndërkohë që paragrafët 1 deri 5 trajtojnë çështje që bien nën objektin e organeve vendore, paragrafi 6 trajton si çështjet që bien nën objektin e organeve të tilla dhe çështje të cilat janë jashtë objektit të tyre, por që i prekin në mënyrë të veçantë organet vendore. Teksti parashikon që mënyra dhe koha e konsultimit duhet të jetë e tillë që t'u lejojë organeve vendore të kenë mundësi reale të ushtrojnë ndikimin e tyre, ndërkohë që pranojnë që rrethanat përjashtimore mund të çojnë në



anashkalimin e kërkesës për konsultim, në veçanti në raste urgjencash. Ky konsultim duhet të zhvillohet drejtpërsëdrejti me organin ose organet e prekura vendore, ose në mënyrë të tërthortë me anë të shoqatave të tyre në rastet kur bëhet fjalë për përfshirjen e disa pushteteve vendore.

### *Neni 5*

Propozimet për ndryshime kufijsh, në të cilat bashkimet me organe të tjera të qeverisjes vendore janë raste ekstreme, pa dyshim janë shumë të rëndësishme për organet vendore dhe për qytetarët të cilëve u shërbejnë këto organe. Ndërkohë që në pjesën më të madhe të rasteve konsiderohet si jo realiste të pritet që komuniteti vendor të ketë kompetenca për të realizuar këto ndryshime, konsultimi paraprak i tij qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë është i domosdoshëm. Referendumet mund të jenë një procedurë e përshtatshme për konsultime të tilla, por për to nuk ekzistojnë dispozita ligjore në shumë vende. Në rastet kur dispozitat ligjore nuk e bëjnë të detyrueshëm referendumin, mund të ushtrohen forma të tjera konsultimi.

### *Neni 6*

#### *Paragrafi 1*

Teksti i këtij paragrafi nuk trajton përbërjen e përgjithshme të organeve të qeverisjes vendore dhe këshillave të tyre, por parashikon mënyrën sesi organizohen shërbimet e tyre administrative. Ndërkohë që ligjet qendrore ose rajonale mund të parashikojnë disa parime të përgjithshme organizimi, organet vendore duhet të jenë në gjendje të urdhërojnë strukturat e tyre administrative të marrin parasysh rrethanat e

tyre vendore dhe efencën administrative. Kërkesa të kufizuara specifike në ligjet qendrore ose rajonale të cilat lidhen, për shembull, me krijimin e komiteteve të caktuara, ose me krijimin e posteve të caktuara administrative, janë të pranueshme, por nuk duhet të jenë aq të përhapura sa të imponojnë një strukturë të ngurtë organizative.

### *Paragrafi 2*

Përveç strukturave të përshtatshme të menaxhimit, është shumë e rëndësishme për efikasitetin dhe efektivitetin e një organi vendor që ai të jetë në gjendje të marrë në punë dhe të mbajë një personel, aftësitë e të cilëve përkojnë me përgjegjësitë e ngarkuara. Qartazi, kjo varet në një shkallë të madhe nga aftësia e organeve vendore për të ofruar kushte mjaftueshërisht të favorshme shërbimi.

### *Neni 7*

Ky nen synon të sigurojë që përfaqësuesit e zgjedhur të mund të mos parandalohen nga veprimi i një pale të tretë nga kryerja e funksioneve të tyre dhe që kategori personash të mos mund të ndalohen nga aspekte tërësisht materiale nga të qëndruarit në detyrë. Kushtet materiale përfshijnë kompensimin financiar për shpenzimet që rrjedhin nga ushtrimi i funksioneve dhe, sipas nevojës, kompensim për humbje të fitimeve dhe shpërblimit dhe mbrojtjes përkatëse sociale, në veçanti në rastet e këshilltarëve që zgjidhen për përgjegjësi ekzekutive me kohë të plotë. Në frymën e këtij neni, do të ishte e arsyeshme të pritët bërja e dispozitave për ri-integrimin e personave që marrin poste me kohë të plotë në jetën normale të punës në fund të mandatit të tyre.

### Paragrafi 3

Ky paragraf parashikon që skualifikimi nga mbajtja e një posti të zgjedhuri vendor, bazohet vetëm në kriteret objektive ligjore dhe jo në vendime *ad hoc*. Normalisht kjo do të thotë që rastet e mospërputhshmërisë duhet të parashikohen në ligj. Duhet thënë se janë vënë re raste të parimeve të fiksuara fort dhe të pashkruara ligjore, të cilat duket se ofrojnë garancitë e nevojshme.

### Neni 8

Ky nen trajton mbikëqyrjen e aktiviteteve të organeve vendore nga organe të niveleve të tjera qeverisëse. Ai nuk lidhet me krijimin e mundësive për individët të ngrenë padi kundër organeve lokale, dhe as me caktimin e një *avokati populli*, ose të aktiviteteve të tij, ose të një organi tjetër zyrtar që ka rol hetues. Mbi të gjitha, dispozitat janë në përputhje me filozofinë e mbikëqyrjes, e cila normalisht shoqërohet me *contrôles de tutelle*, që janë traditë në shumë vende që para shumë kohësh. Në këtë mënyrë, dispozitat merren me praktika të tilla si kërkesat për autorizim paraprak për të vepruar, ose për hyrjen në fuqi të konfirmimit të veprimeve, kompetencën për të anuluar vendimet e një organi vendor, kontrollet kontabël, etj.

### Paragrafi 1

Paragrafi 1 parashikon nevojën e pranisë së një bazë të përshtatshme ligjore dhe përjashton procedurat *ad hoc* të mbikëqyrjes.

### Paragrafi 2

Mbikëqyrja administrative normalisht duhet të kufizohet në çështjen e ligjshmërisë së veprimit të organit vendor dhe jo

në dobinë e tij. Një përjashtim i veçantë, por jo i vetmi, bëhet në rastin e detyrave të deleguara, kur organi që i delegon kompetencat mund të dëshirojë të ushtrojë ca mbikëqyrje mbi mënyrën sesi realizohen ato. Gjithsesi, kjo nuk duhet ta ndalojë organin vendor nga ushtrimi i të drejtave të caktuara, siç parashikohet në nenin 4, paragrafi 5.

### *Paragrafi 3*

Teksti e merr frymëzimin nga parimi i "proporcionalitetit", nëpërmjet të cilit organi kontrollues, gjatë ushtrimit të detyrave të tij, është i detyruar të përdorë metodën që e prek më pak autonominë vendore, ndërkohë që njëkohësisht arrin dhe rezultatet e dëshirueshme.

Përderisa e drejta për të përdorur mjetet efektive ligjore në rastet e kryerjes së parregullt të mbikëqyrjes dhe kontrollit trajtohet nga neni 11, ende nuk janë ndjerë si të domosdoshme dispozita specifike për kushtet dhe mënyrën e ndërhyrjes në situata specifike.

### *Neni 9*

E drejta ligjore për të kryer funksione të caktuara nuk ka kuptim nëse organeve vendore u mohohen burimet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.

### *Paragrafi 1*

Ky paragraf kërkon të sigurojë që organeve vendore nuk u mohohet liria e përcaktimit të përparësive të shpenzimeve.

### *Paragrafi 2*

Parimi për të cilin bëhet fjalë në këtë paragraf është nevoja e ekzistencës së një marrëdhënie të përshtatshme ndërmjet

burimeve financiare të disponueshme për një organ lokal dhe detyrave që kryen ai. Kjo marrëdhënie është veçanërisht e fortë për funksione të cilat i janë caktuar specifikisht organit vendor.

### *Paragrafi 3*

Ushtrimi i përzgjedhjes politike në peshimin e përfitimit të shërbimeve kundrejt kosos për taksapaguesit lokalë, ose për përdoruesit, është një detyrë shumë e rëndësishme e përfaqësuesve të zgjedhur vendorë. Pranohet që ligjet qendrore ose rajonale mund të përcaktojnë kufijtë e përgjithshëm për kompetencat e organeve lokale për tatime dhe taksa, gjithsesi, këto kufij nuk duhet të parandalojnë funksionimin efektiv të procesit të përgjegjshmërisë vendore.

### *Paragrafi 4*

Disa taksa ose burime financiare të qeverive vendore, nga natyra ose për shkak të arsyeve praktike, nuk i përgjigjen relativisht efekteve të inflacionit dhe faktorëve të tjerë ekonomikë. Mbështetja e tepruar në tatime ose burime të tilla mund t'i çojë organet lokale në vështirësi, pasi kostoja e ofrimit të shërbimeve ndikohet drejtpërsëdrejti nga zhvillimi i faktorëve ekonomikë. Gjithsesi, pranohet që edhe në rastin e burimeve relativisht dinamike të të ardhurave nuk mund të ketë lidhje automatike ndërmjet kostove dhe lëvizjeve të burimeve.

### *Paragrafi 6*

Në rastet kur burimet e rishpërndara janë dhënë sipas kriterëve specifike të parashikuara në legjisllacion, parashikimet e këtij paragrafi plotësohen nëse konsultohen organet e qeverisjes vendore gjatë procesit të përgatitjes së legjisllacionit përkatës.

### *Paragrafi 7*

Grantet në bllok, ose madje dhe grantet specifike sipas sektorëve, janë më të preferuara nga pikëpamja e lirisë së organit lokal për të vepruar sesa grantet e dhëna për projekte specifike. Nuk do të ishte realiste të pritej që të gjitha grantet për projekte specifike të zëvendësoheshin nga grante të përgjithshme, në veçanti për investime të mëdha kapitale, por burimet e tepërta për grante të tilla e kufizojnë shumë lirinë e një organi vendor për të ushtruar të drejtën e tij në lidhje me përcaktimin e përparësive të shpenzimeve. Gjithsesi, pjesa e burimeve totale e përfaqësuar nga grantet ndryshon shumë nga një shtet në tjetrin. Një raport më i lartë i granteve për projekte specifike krahasuar me grantet e përgjithshme mund të konsiderohet i arsyeshëm kur grantet në tërësi përfaqësojnë një pjesë relativisht jo domethënëse të totalit të të ardhurave.

Fjala e dytë e nenit 9, paragrafi 7, kërkon të sigurojë që një grant për një qëllim specifik nuk e cenon lirinë e një organi vendor për të ushtruar të drejtën brenda sferës së tij të kompetencave.

### *Paragrafi 8*

Për organet vendore është e rëndësishme të mund të marrin hua financimi për investime kapitale. Gjithsesi, burimet e mundshme të këtij financimi varen në mënyrë të pashmangshme në strukturën e tregjeve kapitale të çdo shteti. Procedurat dhe kushtet për të përfituar nga këto burime mund të parashikohen nga legjislacioni.

### *Neni 10*

#### *Paragrafi 1*

Ky paragraf mbulon bashkëpunimin ndërmjet organeve vendore mbi një bazë funksionale, veçanërisht me kuadrin e

kërkimit të një eficence më të madhe nëpërmjet projekteve të ndërsjella, ose nëpërmjet kryerjes së detyrave që shkojnë përtej kapacitetit të një organi të vetëm. Një bashkëpunim i tillë mund të marrë formën e krijimit të konsorciumeve ose federatave të organeve, megjithëse kuadri ligjor për krijimin e strukturave të tilla mund të parashikohet në ligj.

### *Paragrafi 2*

Paragrafi 2 flet për shoqatat objektivat e të cilave janë shumë më të përgjithshme se aspektet funksionale të paragrafit 1, dhe që normalisht kërkojnë të përfaqësojnë të gjitha organet vendore të një lloji të caktuar, ose të disa llojeve, në nivel rajonal ose kombëtar. E drejta për të qenë pjesë e organizatave të kësaj natyre nuk nënkupton njohjen nga qeveria qendrore të një shoqate individuale si bashkëbisedues të vlefshëm.

Në një instrument të këtij lloji në Këshillin e Evropës, është normale që e drejta për të qenë pjesë e shoqatave në nivelin kombëtar të shoqërohet nga e drejta paralele për të qenë pjesë e shoqatave ndërkombëtare, disa prej të cilave luajnë rol aktiv për nxitjen e unitetit evropian në linja që janë në përputhje me qëllimet e parashikuara në statutin e Këshillit të Evropës.

Gjithsesi, neni 10.2 ua lë në dorë shteteve individuale të përzgjedhin mjetet, qofshin ato legjislative ose jo, të cilat bëjnë të mundur vënien në jetë të parimit.

### *Paragrafi 3*

Duhet të lejohet po ashtu dhe bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me organe vendore individuale të shteteve të tjera, megjithëse mënyra e këtij bashkëpunimi duhet të respektojë rregullat e

përgjithshme ligjore që ekzistojnë në secilin shtet dhe duhet të zhvillohet brenda kuadrit të kompetencave të organeve në fjalë.

Dispozitat e Konventës Evropiane të Ravijëzimit të Bashkëpunimit Ndërkufitar ndërmjet Komuniteteve ose Autoriteteve Territoriale (21 maj 1980, ETS nr. 106) janë posaçërisht me vend në këtë aspekt, megjithëse disa forma bashkëpunimi nuk është e nevojshme të kufizohen në zonat kufitare.

### *Neni 11*

Nëpërmjet rekursit në mjete efektive juridike nënkuptohet e drejta e një organi vendor për të përdorur:

- a. një gjykatë të krijuar mbi bazën e ligjit, ose
- b. një organ ekuivalent, të pavarur, ose statusor, që ka të drejtë të vendosë ose të këshillojë për marrje vendimi, nëse një veprim, mosveprim, vendim ose akt tjetër administrativ është ose jo në përputhje me ligjin.

Është vënë re një rast në një shtet ku, megjithëse vendimet administrative nuk ishin objekt apelimi të zakonshëm në gjykatë, ishte e mundur të përdorej një mjet ligjor i jashtëzakonshëm, i quajtur kërkesë për rihapje procesi. Ky mjet efektiv juridik, i cili mund të përdoret nëse vendimi bazohet në një zbatim jo korrekt të ligjit, është në përputhje me kërkesat e këtij neni.

### *Neni 12*

Formulimi i parimeve të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara në pjesën e parë të kartës, duhej të përpiquej të përfshinte larminë e gjerë të sistemeve ligjore dhe strukturave të qeverive vendor që kanë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Pavarësisht nga kjo, pranohet që qeveri të caktuara mund të



kenë ende pengesa kushtetuese ose praktike për t'u angazhuar për të respektuar dispozita të caktuara të Kartës.

Si pasojë, ky nen përcakton sistemin "e bërthamës së nevojshme", së krijuar për herë të parë nga Karta Sociale Evropiane, duke parashikuar që palët në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore kërkohet që të paktën të angazhohen për përmbushjen e njëzet nga tridhjetë paragrafët e pjesës së parë të kartës, duke përfshirë të paktën dhjetë nga bërthama e katërmbëdhjetë parimeve bazë. Gjithsesi, për shkak se qëllimi përfundimtar mbetet përputhshmëria me të gjitha dispozitat e Kartës, palët lejohen specifikisht që të shtojnë mbi angazhimet fillestare angazhime të tjera kur kjo gjë të bëhet e mundur për ta.

### *Neni 13*

Në parim kërkesat e parashikuara në pjesën e parë të kartës lidhen me të gjitha kategoritë ose nivelet e organeve vendore për secilin shtet anëtar. Mundësisht, ato zbatohen dhe për organet rajonale, në rast se ekzistojnë organe rajonale në shtetet anëtare. Gjithsesi, forma e veçantë ligjore, ose statusi kushtetues i rajoneve të caktuara (në veçanti shtetet anëtare të federatave) mund të përjashtojë zbatimin e të njëjtave kërkesa si ato të organeve lokale. Më tej, në një ose dy shtete anëtare ekziston një kategori e organeve vendore të cilat, për shkak të përmasave të tyre të vogla, kanë vetëm kompetenca të vogla ose konsultative. Për të marrë parasysh raste të tilla përjashtimore, neni 13 i lejon palët të përjashtojnë kategori të caktuara organesh nga objekti i kësaj Karte.

#### *Neni 14*

Synimi i këtij neni është të lehtësojë monitorimin e zbatimit të Kartës nga palët, duke krijuar detyrimin që ato t'i japin informacionin e nevojshëm Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës. Në veçanti, në mungesë të një organi të posaçëm përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kartës, është posaçërisht e rëndësishme që Sekretarit të Përgjithshëm t'i jepet informacioni në lidhje me ndryshimet e legjislacionit, ose në lidhje me masat e tjera që kanë rol domethënës në autonominë vendore, siç përcaktohet në kartë.

#### *Nenit 15 deri në 18*

Klauzolat përmblylëse të përfshira në nenet 15 deri në nenin 18 bazohen në modelin e klauzolave përfundimtare të konventave dhe marrëveshjeve të hartuara brenda Këshillit të Evropës.

Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Lokale është traktati i parë detyrues ndërkombëtar, i cili garanton të drejtat e komuniteteve dhe të organeve të tyre të zgjedhura. Karta u hap për nënshkrim si Konventë nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës më 15 tetor 1985 dhe hyri në fuqi më 1 shtator 1998. Më 16 nëntor 2009 u miratua Protokollin Shtesë për të drejtën për të marrë pjesë në çështjet e organeve lokale për të plotësuar tekstin e Kartës. Protokollin Shtesë hyri në fuqi më 1 qershor 2012. Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale siguron respektimin e parimeve të Kartës nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që e kanë nënshkruar dhe e kanë ratifikuar Kartën dhe Protokollin e saj Shtesë.

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale është organ institucional i Këshillit të Evropës. Ai përfaqëson organet lokale dhe rajonale, duke forcuar demokracinë lokale në 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. I përbërë nga dy dhoma, Dhoma e Autoriteteve Lokale dhe Dhoma e Rajoneve, Kongresi është zëri institucional i mbi 200,000 bashkive dhe rajoneve evropiane.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Ai përbëhet nga 47 shtete anëtare, 28 prej të cilave janë anëtare të Bashkimit Evropian. Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale është një institucion i Këshillit të Evropës, përgjegjës për forcimin e demokracisë lokale dhe rajonale në 47 shtetet anëtare të tij. I përbërë nga dy dhoma - Dhoma e Autoriteteve Lokale dhe Dhoma e Rajoneve - dhe tre komisione, ai sjell së bashku 648 zyrtarëve të zgjedhur që përfaqësojnë më shumë se 200.000 autoritetet lokale dhe rajonale.